



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 15, datë 06.03.2024

PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARES
ZNJ.ALNEIDA RROSHI

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e Ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar; neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 47, gërma”c”, neni 49, pika 4, gërma”c”, pika 5, neni 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkisë Durrës, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve, në mbledhjen e datës 06.03.2024,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Mbarimin para afatit të mandatit të këshilltares së Këshillit Bashkiak Durrës, znj. Alneida Nexhmi Rroshi, për shkak se merr një funksion të papajtuëshëm me funksionin e Këshilltarit.
2. Të shpall vakancën për në Këshillin Bashkiak.
3. Për këtë vendim të njoftojë Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.
4. Ngarkohet Sekretari Këshillit Bashkiak, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 162 Prot.

Durrës, më 13 03 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.15 datë 06.03.2024
“Për mbarimin përpara afatit të mandatit të Këshilltares Znj. Alneida Rroshi”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

